



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇESHTJEVE JURIDIKE
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOOËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut Fier Nr.Prot. 489/, Data 10.05.2023
Shkurtimi i lëndës Ithim parafjalor 2885

Për trajtim nga:	<u>Zj. Selim Heklo</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Zj. Peli To</u>
Me porosi:	<u>Aj. Selim</u>

Afati: normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/ për dijani Tjetër ___ ditë
Data 11.05.2023, Nr.Prot 2885/1

Marrë në dorëzim: _____
Kalon për trajtim (struktura): _____
Me porosinë: _____
Nënshkrimi: (TITULLARI) _____
Nënshkrimi _____

Marrë në dorëzim: _____
Kalon për trajtim (struktura): _____
Me porosinë: _____
Nënshkrimi _____

Marrë në dorëzim: _____
Kalon për trajtim specialisti: _____
Me porosinë: _____
Nënshkrimi _____

Trajtim i materialit përfunduar më: _____, Specialisti
Trajtim i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
Trajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
Trajtim i materialit miratuar më: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 494 / Prot.

Fier, më 10.05.2023

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 48, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 27.04.2023.

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 2885 prot. datë 28.04.2023, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 494 prot. datë 05.05.2023, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 8, shkronjat “a”, dhe “j” dhe neni 16, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 27.04.2023, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 6, datë 27.04.2023, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 112, prot. datë 10.01.2023, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimit, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 48, datë 27.04.2023, “Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023” shoqëruar nga projektvendimi Nr. 48, datë 27.04.2023, protokolluar me Nr. 2856 prot. datë 27.04.2023, relacioni shpjegues Nr. 2856/1 prot. datë 27.04.2023, është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, neni 29, pika 1; Ligjin Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65, pika 3; Ligjin Nr. 9936, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 6; Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6, shkronja “d”; VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3, nënpika 3.1, shkronja “b” pika 5 si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Lefter Shëhaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2876 Prot.

Roskovec, më 28.04 2023

VENDIM

NR 42. DATË 27.04. 2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MARS 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.03.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2146/1 Prot.

Roskovec, më 31.03.2023

Procesverbal Nr.5

-I mbajtur sot, date 30.03.2023, ora 12³⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt dhe mbledhjes jashtë radhe 2023.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2023.
5. Për miratimin e raportit të punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
6. Për miratimin e raportit të transparencës në vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2022.
7. Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2024-2026.
8. Për zbatimin e çmimit për ton/mbetje urbane dhe lidhjen e aktmarrëveshjes për mbetjet që depozitohen në Landfill (Incenerator Fier).
9. Për miratim fondi për detyrimin financiar si anëtare e Shoqatës MedCities.
10. Për miratimin e Logos së 100 vjetorit të Roskovecit si Njësi Administrative.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 12⁴⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, E.Çepele, L.Goga, B.Kuka, T.Kuka, K.Hyska, V.Bakaj, V.Dogani, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne :Rr.Hazizi, L.Hoxha, B.Cobo, D.Hoxha, G.Hoxha, A.Sheme, B.Toska.

Prezent nga bashkia: Nenkryetari i bashkise M.Goga, Dr.Ekonomise, Sp.Sherbimit Social, P/Dr.Kultures dhe Njesise se Integrimit European, P/Dr.Juridike, Perf.Komunitetit Rom.

Me plotesimin e kuorunit , kryetari hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 11 keshilltare. Para se te filloje me mbledhjen, Kryetari ben me dije se na kane ardhur disa materjale shtese, te cilat duhet ti fusim sot ne rendin e dites. Projekt-vendimet shtese jane : “Per miratim fonde shtese ne buxhetin e bashkise Roskovec per vitin 2023”, “Per dhenien e autorizimit te Kryetarit te Bashkise qe ti bashkohet dhe te firmose marreveshjen e kryetareve te bashkise per klimen dhe energjine per Ballkanin Perendimor dhe Turqine”, “Per miratimin e bashkefinancimit per programet e strehimit social”, “Per miratimin e nivelit te qirase mesatare ne treg te lire per vitin

2023".Keto jane projekt-vendimet qe na kane ardhur sot shtese.I hedh ne votim per ti shtuar dhe futur ne rendin e dites dhe miratohen unanimsisht me 11 vota pro.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesat e bera si me siper dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt dhe mbledhjes jashtë radhe 2023.

Informacioni ka te bej me vendimet e miratuara ne mbledhjen e Shkurtit dhe vendimet e miratuara ne mbledhjen jashte radhe te dates 15.03.2023,ndarja e vendimeve si dhe miratimi i Prefektures.Nuk ka diskutime.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

4.Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 Shkurt 2023.

Sp.Sonila Rrapushi sqaron materjalin.Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim projekt-vendimi i 6% per muajin Shkurt dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

5. Për miratimin e raportit të punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2022.

Sekretarja e keshillit sqaron raportin e punes se Keshillit per vitin 2022,i cili ka te bej me gjithe punen vjetore,sa vendime jane miratuar,sa kane qen normative,sa prej tyre nuk jane konfirmuar nga Prefektura,si dhe gjithe procedurat e punes se vitit 2022.Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim raporti i punes se KB per vitin 2022 dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

6. Për miratimin e raportit të transparencës në vendimmarrje të Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2022.

Sekretarja e keshillit sqaron materjalin,i cili ka te bej me transparencen e keshillit ne punen e tij,sa degjesa publike jane realizuar,si ka qene pjesmarrja e qytetareve,dhenia e rekomandimeve dhe sugjerimeve,etj.Hidhet ne votim raporti i transparences ne vendimmarrje i KB per 2022 dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

7.Për miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2024-2026.

Dr.Ekonomise S.Cepele sqaron projekt-vendimin.Sqaron tavanet pergatitore te shpenzimeve te PBA 2024-2026,sipas formateve standarte te instrumentit te planifikimit financiar C1 burimet buxhetore dhe D1 tavanet buxhetore.Ne pergatitjen e tavaneve eshte marr ne konsiderate prioritetet e komunitetit te dala nga sondazhi online i keshillit.Hidhet ne votim projekt-vendimi i tavaneve pergatitore te PBA 2024-2026 dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

8.Për zbatimin e çmimit për ton/mbetje urbane dhe lidhjen e aktmarrëveshjes për mbetjet që depozitohen në Landfill (Incenerator Fier).

P/Dr.Juridike sqaron materjalin,i cili ka te bej me zbatimin e cmimit per ton/mbetje urbane qe do depozitohen ne incinerator,sipas percaktimit te ber ne projekt,si dhe lidhjen e aktmarreveshjes.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimsisht me 11 vota pro.

9.Për miratim fondi për detyrimin financiar si anëtare e Shoqatës MedCities.

Dr.Finances sqaron projektin.Ky fond ka te bej si nje detyrim financiar per pjesmarrjen e kryetares se bashkise si anetare e shoqates se huaj "MedCities",i cili do te perballohet nga fondet e

planifikuara per administraten per 2023.Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimsht me 11 vota pro.

10.Për miratimin e Logos së 100 vjetorit të Roskovecit si Njësi Administrative.

Nenkryetari Maksi sqaron se kjo logo ka te bej me 100 vjetorin e Roskovecit si Njesi Administrative.Kemi studiuar historikun e bashkise,dhe ne kuader te 100 vjetorit te Roskovecit si Njesi Administrative ne kemi propozuar qe krahas logos zyrtare ne krahe te saj te vendoset kjo logo e cila do perdoret deri ne fund te vitit 2023.Kjo do te jete nje logo symbol per festen e 100 vjetorit te Roskovecit,dhe do te perdoret ne shkresa perkrah logos tone zyrtare,nga hyrja ne fuqi e ketij vendimi deri ne fund te ketij viti.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekt-vendimi i miratimit te logos se 100 vjetorit te Roskovecit si Njesi Administrative dhe miratohet unanimsht me 11 vota pro.

11.Per miratim fonde shtese ne buxhetin e bashkise Roskovec per vitin 2023.

Dr.Selmani sqaron projektin.Sqaron se ka te bej me fond shtese i financuar nga Keshilli i Europes,financim per programin Romacted 2,dhe do perdoret per rehabilitimin e ujrave te ndotura dhe ndertim i vepres se pastrimit ne lagjen e liqenit te Kurjanit,dhe per fuqizimin e komunitetit Rom dhe Egjiptjan.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimsht me 11 vota pro.

12.Per dhenien e autorizimit te Kryetarit te Bashkise qe ti bashkohet dhe te firmose marreveshjen e kryetareve te bashkise per klimen dhe energjine per Ballkanin Perendimor dhe Turqine.

P/Dr.Kultures sqaron projektin.Ju paraqesim per miratim autorizimin e Kryetarit te bashkise qe ti bashkohet dhe te nenshkruaj marreveshjen e Kryetarit per klime dhe energji,per Ballkanin Perendimor dhe Turqine,sipas sqarimit qe keni ne relacion.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimsht me 11 vota pro.

13.Per miratimin e bashkefinancimit per programet e strehimit social.

P/Dr.Juridike D.Fejzulla sqaron projektin.Keshilli i bashkise e ka miratuar fondin per programet e strehimit social,pra kete fond ju e kemi miratuar,por Ministria na ka nisur nje imeil dhe kerkon qe ta miratojme ne kete model qe ju kemi paraqitur sot,bashkefinancimin e bashkise ne keto programe.Hidhet ne votim projekt-vendimi sipas materjalit dhe miratohet unanimsht me 11 vota pro.

14.Per miratimin e nivelit te qirase mesatare ne treg te lire per vitin 2023.

P/Dr.Juridike sqaron projekt-vendimin.Edhe kete projekt na e ka kerkuar Ministria.Ju kemi propozuar per miratim nivelin e qirase mesatare ne treg te lire per vitin 2023,sipas strukturave te apartamenteve ne zonat urbane dhe rurale,sipas vlerave qe keni ne materjal.Hidhet ne votim projekti i nivelit te qirase mesatare ne treg te lire per 2023 sipas materjalit dhe miratohet unanimsht me 11 vota pro.

15.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Vjollca-pyet per rruget,kur do behen,rruga e bakallareve?Kryetari-ato qe i kemi miratuar ne do behen,por ka procedura dhe duan pak kohe.Nuk ka me diskutime.Kryetari i falenderon dhe mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2877 prot

Roskovec, më 28.04.2023

VENDIM

Nr. 43 datë 27/04/2023

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR
DERI 6% PËR PERIUDHËN 1-31 MARS 2023**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2,9,24, të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmëse ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB Nr.3 datë 27.01.2023 “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin **Mars 2023**, në total **24 (njëzetë e katër)** familje me fond total prej **111808 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetë)** lekë. Konkretisht:

PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2023, **4 (katër)** familje me një fond **12173 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE STRUM

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2023, **8 (tetë)** familje me një fond **39205 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2023, 4 (**katër**) familje me një fond 20830 (**njëzetë mijë e tetëqind e tridhjetë**) lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2023, 8 (**tetë**) familje me një fond 39600 (**tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind**) lekë.

- Ngarkohet sektori i Financës dhe sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska



Bashkia Roskovec
Mars 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Agron Osmën Çanta		1	Familje në nevojë	2178
2	Besnik Mustafa Çepele		2	Familje në nevojë	3703
3	Bukuroshe Sali Çepele		1	Familje në nevojë	3146
4	Selvi Rystem Çepele		1	Familje në nevojë	3146
	Shuma				12173

Mbyllet me nr rendor 4(katër)


KRYETAR KËSHILLI
Kadri Hyska



FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Agroseda Arben Musko		2	Familje në nevojë	5940
2	Arta Bilbil Rroko		3	Familje në nevojë	7920
3	Astrit Shefqet Dogani		3	Familje në nevojë	3703
4	Natasha Mehmet Cepele		1	Familje në nevojë	2178
5	Nurie Selman Hazizi		2	Familje në nevojë	3703
6	Rajmonda Halim Ziu		3	Familje në nevojë	4138
7	Rrapi Llazi Vasa		2	Familje në nevojë	3703
8	Zamira Ajet Kasa		3	Familje në nevojë	7920
	SHUMA				39205

Mbyllet me numrin rendor 8(tetë)



Njësia Administrative Kuman
Mars 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Atesit Mbiemër	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	ndihmes	Shuma
1	Eduard Riza Hoxha		3	Familje në nevojë	4792
2	Eugerta Medin Satëri		3	Familje në nevojë	7920
3	Klaudja Viktor Metaj		2	Familje në nevojë	5940
4	Yllka Shefqet Refitaj		1	Familje në nevojë	2178
2	Shuma				20830

Mbyllet me nr rendor 4(katër)

KRYETAR-KËSHILLI

Kadi Hyska



Njësia Administrative Kurjan
MARS 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Ramadan Gani Koronaj		1	Familje në nevojë	5720
2	Donika Hysni Lika		1	Familje në nevojë	3466
3	Kamber Riza Lamaj		3	Familje në nevojë	4356
4	Ludjana Namik Shabanaj		3	Familje në nevojë	7920
5	Yzedin Shaban Panahori		2	Familje në nevojë	3703
6	Turand Laver Lika		3	Familje në nevojë	4792
7	Fatmira Xhevair Abedinaj		2	Familje në nevojë	5940
8	Petrit Riza Shabanaj		2	Familje në nevojë	3703
	Shuma				39600

Mbyllet me nr rendor 8 (tetë)

KRYETAR KËSHILLI

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2878 Prot.

Roskovec, më 28.04 2023

VENDIM

Nr. 44 datë 27/04 /2023

PËR

**ANULIM TË VENDIMIT NR.29 DATË 15.03.2023
“PËR MIRATIM TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
PËR VITIN 2023 ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113, shkresës Nr.327/1 datë 28.03.2023 të Prefektit të Qarkut Fier, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Anulimin e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.29 datë 15.03.2023 “Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023”.
2. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2879 Prot.

Roskovec, më 28.04 2023

VENDIM

NR. 45 DATË 27.04.2023

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “VLERËSIMI I RISKUT NË SHKALLË
VENDORE”**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, nenit 54, shkronja “k” dhe bazuar në ligjin Nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, nenit 9, pika 5, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Vlerësimi i riskut në shkallë vendore”, bashkia Roskovec, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi, si një detyrim ligjor, i cili ka për qëllim zvogëlimin dhe menaxhimin e fatkeqësive.
2. Dokumenti “Vlerësimi i riskut në shkallë vendore”, do të zbatohet për periudhën kohore 2023-2026.
3. Ngarkohen strukturat e bashkisë Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1880 prot.

Roskovec, më 28.04.2023

VENDIM

Nr. 46, datë 27/04/2023

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM TË NJË AMBIENTI ZYRE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Neni 54, pika (e)/1, Ligj Nr. 65/2016 datë 9.6.2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendim Nr. 16, datë 12.1.2018 "Për Miratimin E Listës Së Veprimtarive Që Ushtrojnë Ndërmarrjet Sociale" si dhe kuadrit ligjor mbi të cilin mbështeten marrëdhëniet midis OJF-ve dhe qeverisjes vendore, konkretisht: Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", të ndryshuar, Ligjit Nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënie në përdorim të një ambienti, pa pagesë, për një vit me të drejtë përsëritje, i cili do të shërbejë si ambient i përbashkët për të gjithë grupin (gra/vajza) për të punuar dhe promovuar produktet e tyre artizane. Saktësisht ky ambient ndodhet në Pallatin e Kulturës pasuri Nr. 3/338, zk 3196 me sipërfaqe 48 m².
2. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Çështjeve Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Bashkëlidhur: Planimetria e Objektivit.

KRYETAR
Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2881 prot.

Roskovec, më 28.04.2023

VENDIM

NR 47.DATË 27.04.2023

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE
NË FONDIN PYJOR/KULLOSORË PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; dhe në bazë të ligjit Nr. 25/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet” dhe të VKM Nr.570 datë 17.07.2019 “Për krijimin,organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” si dhe mbështetur në VKM-në Nr.1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota,si dhe për krijimin e njësisve vullnetare të shuarjes së zjarreve”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e planit për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor për vitin 2023.
2. Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Pyjeve,Ujitjes dhe Kullimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dhe plani i masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit në pyje.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 2829/1 prot.

Roskovec, më 27. 4. 2023

Lënda: Relacion mbi “Planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosorë për vitin 2023”

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; në bazë të ligjit nr 25/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, të VKM nr.570 datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” si dhe mbështetur në VKM-në nr.1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve”

Po ju paraqesim për miratim “Planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor për vitin 2023”. Krahas detyrimit ligjor është i nevojshëm miratimi i këtij plani masash për t’i paraprir sezonit të thatësisë ku edhe rastet e rënies së zjarrit në pyje janë më të shpeshta. Gjithashtu është i nevojshëm për të organizuar grupet e punës dhe infrastrukturën e nevojshme për shuarjen e zjarreve për të bërë minimizim dhe eliminimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret.

Konceptoi: V.Kola

Konfirmoi: A.Dardha

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Sektori i Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit

MIRATOHET
KRYETARI
Mehinda Bufi

PLANI MASAVE

PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI

PËR VITIN 2023

Baza ligjore:

Ligji nr.57/2020 “Për Pyjet “

Ligji nr. 3693 date 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar,

Ligjin nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetë Qeverisjen Vendore”,

Ligji nr.152 date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”,


VKM-në nr.1080 date 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njëjësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”.

Për parandalimin dhe shuarjen në kohë të zjarreve në pyje dhe kullota Sektori i Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit në Bashkinë Roskovec përgatit këtë plane masash:

Nr	Pershkrimi i objektivit qe duhet te realizohet	Pershkrimi i masave qe do te merren ne zberdhim te objektivit	Afatet e permbohshjes së çdo mase	Percaktimi i treguesve konkret per vleresimin e realizimit te çdo mase	Kush ngarkohet per realizimin e masave
1	Plani veprimeve parandaluese per menaxhimin e zjarreve ne pyje e kullota	<p>Ngrihet shtabi per mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarri ne Drejtorine e Pyjeve, i përbërë nga:</p> <p>Agron Dardha Keshilltar i Kryetares per Drejtorin Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Kryetar</p> <p>Viktor Kola Përgjegjës i Sektorit të pyjeve, ujitjes dhe kullimit Anetar</p> <p>Genc Doksani Teknik per menaxhimin e pyjeve Anetar</p> <p>Bujar Dyle Roje pyjesh Anetar</p> <p>Te ngrihen shtabet e MNZ per mbrojtjen e pyjeve e kullotave nga zjarri prane Njësive Administrative.</p> <p>Ne perberje te shtabeve te jete dhe nje perfaqesues i sektorit te pyjeve dhe kullotave qe punojne ne terren.</p>	30.05.2023	<p>Bene vleresimin konkrete te situates/situatave te krijuara.</p> <p>Merrë vendime dhe masa te nevojshme qe kane si objekt per miresimin e punes.</p> <p>Ushtron kontrole ne vazhdimesi per zbatimin e masave per mbrojtjen nga zjarret.</p> <p>Harton dhe shperndan komunikata periodike per shtypin.</p> <p>Harton planin e veprimit</p>	Drejtoria e Bujqsisw dhe zhvillimit rural Sektori i pyjeve, ujitjes dhe kullimit
2	Sensibilizim i komunitetit	<p>Te pergatitet nje material prezantues me teme Rreziku dhe Mbrojtja nga Zjarri.</p> <p>Te pergatiten flete palosje dhe pankarta per mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.</p>	30.05.2023	Prezantohet materiali me te gjithë palet e interesuara, bizneset, fermeret, pronaret privat, komunitetin e zones.	Emergjencat Civile Sektori i pyjeve, ujitjes dhe kullimit
3	Ngritja e skuadrave vullnetare te MZSH.se	<p>Mbi bazen e VKM 1080, date 22.12.2010, "Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota, si dhe per krijimin e njesive vullnetare te shuarjes se zjarreve" dhe te ligjit nr.152, date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" neni 13, te organizohen skuadrat vullnetare te gadishmerise per MNZSH.se.</p>	30.05.2023	Organizohen njesite vullnetare per shuarjen e zjarreve ne çdo fshat dhe Njesi Administrative	Sektori i pyjeve, ujitjes dhe kullimit Njesite Administrative

4	<p>Perdorimi efektiv i burimeve njerëzore, materialeve financiare dhe bashkepunimi me institucionet e tjera shtetërore</p>	<p>Drejtoria e Pyjeve te shperndaje menjehere hartën e rezikut nga zjarret per pyjet me rrezikshmeri te larte. Vemendje te vecante duhet te tregohet ne pyjet me vlera turistike, ne zonat e brezit pyjor mbrojtës bregdetar, te merren masa suplementare sherbimi kunder zjarrit, sidomos per ditet e shtuna dhe te djela, duke disiplinuar levizjen e vizitoreve dhe te mjeteve.</p>	<p>Ne vazhdimesi</p>	<p>Sistemi i informimit me telefon te jete efektiv. Mjetet te jene ne gadishmeri, ne funksion te shuarjes se zjarrit. Te zbatohet me korrektesi rregullorja e mbrojtjes se pyjeve dhe kullotave nga zjarri</p>	<p>Sektori i pyjeve, ujitjes dhe kullimit Njesite Administrative</p>
5	<p>Informimi i publikut</p>	<p>Do organizohen takime sensibilizuese dhe spote publicitare per ndergjegjesimin e opinionit publik per demet qe shkaktojne zjarret ne pyje e kullota dhe nevojën e bashkepunimit ne procesin e parandalimit dhe shuarjes se zjarreve.</p>	<p>Ne vazhdimesi</p>	<p>Te prodhohen postera dhe fletpalosje te shoqeruar me problematiken e zjarreve ne pyje. Te kontraktohen tv lokale per dhenie spotesh dhe tema per shuarjen e zjarreve.</p>	<p>Sektori i pyjeve, ujitjes dhe kullimit Emergjencat Civile</p>
6	<p>Kontrolle operative</p>	<p>Per zbatimin e ketij program masash, ngarkohen Njesite Administrative dhe Drejtoria Pyjeve. Per te gjitha rastet e zjarreve te behen analiza te vecanta duke marre masat e nevojshme.</p>	<p>Ne vazhdimesi</p>	<p>Te meren masat parandaluese ne kohën e duhur per rritjen efektivitetit te punes ne rastet e zjarreve.</p>	<p>Sektori i pyjeve, ujitjes dhe kullimit Njesite Administrative</p>

Përgjegjësi sektorit të pyjeve, ujitjes dhe kullimit
Viktor Kola



Drejtori i Bujqësië dhe Zhvillimit Rural
Agron Dardha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2882 Prot.

Roskovec, më 28, 04 2023

V E N D I M

Nr. 48, datë 27/04 /2023

“ P Ë R M I R A T I M T Ë P Ë R D O R I M I T T Ë F O N D I T T Ë E M E R G J E N C A V E C I V I L E P Ë R V I T I N 2 0 2 3 ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3, neni 29 dhe neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore”, neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 dhe 45, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM Nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3 paragrafi 3/1 gërma b, të VKB Nr.98 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2023” si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektorit të zbatueshmërisë së Investimeve ;Këshilli i Bashkisë,

-V E N D O S I :

- I. Të miratohet përdorimi i fondit për objektin : “Rikonstruksion i shkarjes në rrugën Lamaj, fshati Mbërs, 1050 ml” në shumën 4,999,918 lekë, i cili të përballohet nga fondi i kushtëzuar i Emergjencave Civile 2023.

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plote e objektit	2023	2024
1.	17	10910	1	604	Rikonstruksion i shkarjes në rrugën Lamaj, fshati Mbërs, 1050 ml”	4,999,918	4,999,918	0
					SHUMA:	4,999,918	4,999,918	0

- II. Ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2883 prot

Roskovec, më 28/04/2023

VENDIM

NR. 49 DATË 27.04.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTIN ME OBJEKT “ ASFALTIMI I RRUGËVE
TË BRENDSHME NË LAGJET E BASHKISË ROSKOVEC ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

YLSHIM:

1. Miratimin e ndryshimeve dhe shtesë në disa rrugë të projektit me objekt: **“ASFALTIMI I RRUGËVE TË BRENDSHME NË LAGJET E BASHKISË ROSKOVEC ”**
2. Ndryshim të gjatësisë dhe gjerësisë së rrugës për projektin me objekt: **ASFALTIMI I RRUGËVE TË BRENDSHME NË LAGJET E BASHKISË ROSKOVEC ”.**
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2884 prot

Roskovec, më 28/04/2023

VENDIM

NR 50 .DATË 27 . 04 .2023

“PËR VENDOSJEN E KRITERIT MOSPËRDORIM I RËRËS BITUMINOZE SI MATERIAL PËR SHITESAT RRUGORE NË ZONAT E BANUARA”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Vendosijen e kriterit “ Mospërdorim i materialit “Rërë Bituminoze” si material shtresash rrugore në zonat e banuara”.
2. Materiali “ Rërë Bituminoze” do të mund të përdoret vetëm në rrugë periferike dhe larg qendrave të banuara.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

